

## **Rregullore për nxënësit dhe nxënëset për përdorimin e mediumit informatik në shkollat e qytetit të Schaffhausen-it, e cila është në pronësi të qytetit**

Të gjithë nxënëset dhe nxënësit e shkollës fillore nga klasa e 4 deri në klasën e 6, si dhe të klsave të larta nga klasa e 1 deri në klasën e 3-të, do të pajisen me një mjet personal të huazuar.

Të gjithë nxënësit dhe nxënëset e klasës primare nga e 4- deri te e 6, si dhe nxënësit e klasës së lartë nga 1 – deri te e 3(apo klasa e 7-9) do të furnizohen me një mjet të huazuar.

Mjeti i huazuar dhe paisjet e tij mbeten gjatë gjithë vitit shkollor në pronësi të qytetit të Schaffhausen-it dhe pas largimit nga shkolla duhet që ti dorzohen shkollës në gjendje të mirë dhe funksionale.

Ne besojmë që ju do ta trajtoni dhe do të silleni me kujdes me mjetin e huazuar dhe për këtë i kemi paraqitur pikat më kryesore në rregullore, se si të silleni me këto mjete.

### **Detyrat dhe të drejtat e nxënësve: e nxënseve**

- Shfrytëzimi i mjetit të huazuar si mjet pune në orë të mësimi sipas udhëzimeve të arsimtarëve/eve
- Jeni të detyruar që t'i përmbaheni Ligjit të zbatueshem(veçanërisht të drejtës penale, mbrojtja e privatësisë, mbrojtja ligjore e të dhënave, mbrojtja e së drejtës së autorit)
- Me lejen e prindërve/kujdestarëve ligjor, keni të drejtë ta përdorin mjetin e huazuar edhe jashtë shkollës.
- Jeni të detyruar që mjetin e huazuar dhe paisjet e tij ti trajtoni me kujdes dhe të siguroheni që të mos humbet.
- Silleni mjetin e huazuar me bateri të mbushur në shkollë, në qoftë se nuk do të ju nevojitet për detyra shtëpie, atëherë deponojeni në fund të ditës në mënyrë të sigurt në shkollë.
- Mbani përgjegjësi që mjeti i huazuar gjatë orës mësimore të jetë gjithmon i gatshëm për përdorim.
- Jeni të detyruar që të punoni me Softwerin e instaluar apo të siguruar nga shkolla. Softwer tjetër s'guxon të instalohet.
- Përdore mjetin e huazuar në hapësirat e shkollës vetëm për deryra të shkollës dhe përmbaju rregullave të shkollës
- Mos e mbishkruaj mjetin e huazuar dhe mos i largo etiketat që përmban ai. Në qoftë se i bie njëra nga etiketat, atëher menjëher lajmrohe kujdestaren(mësuesen) e klasës tënde.
- Mjetin e huazuar si dhe fjalëkalimin tënd mos ua jep të tjerëve.
- Të jeni të vetëdijshëm që, me mjetin e huazuar nuk guxoni të hapni, as ti ruani apo ti dërgoni faqet, që në veti përmbajnë racisëm, ku lëvdohet dhuna, si dhe përmbajtjet pornografike.
- Përpilimi dhe përhapja e inçizimeve(Fotografive, zërit, filmave) të personave duhet të bëhet vetëm me pëlqimin e tyre.
- Inçizimi gjatë orës së mësimi duhet të bëhet vetëm me urdhërin e arsimtarit.
- Hyrja në rrjetat sociale bëhet vetëm me lejen e arsimtarit.
- Jeni të detyruar që arsimtarit dhe kujdestarit ligjorë në çdo kohë ti mundësoni qasje dhe ti tregoni se çfarë keni ruajtur në mjetin e huazuar.
- Respekttoni rregullat, të cilat prindërit i vendosin në shtëpi.
- Barteni mjetin e huazuar në një çantë të duhur(psh. çanta e shkollës, çantë shpine) në të cilën do të jetë mirë i mbrojtur.
- Lëreni mjetin e huazuar gjatë rrugës për në shkollë në çantë; përjashtimet do ti definojë arsimtari
- Lajmëroje kujdestarin e klasës menjëher, nëse mjeti i huazuar është dëmtuar ose nëse ta kanë vjedhur.
- Siguroni ruatjen e të dhënave juaja rregullisht. Të dhënat të cilat janë të ruajtura vetëm në mjetin e huazuar, mund të fshihen, në rast riparimi, ndërimit të mjetit ose kur do t'ia ktheni mjetin shkollës.

## Roli i shkollës dhe qytetit: qyteti i Schaffhausen-it...

- I financon mjetet e huazuara dhe është pronar i tyre si dhe i Software-it dhe Datave.
- Siguron mbështetjen e mjetëve të shkollës dhe është përgjegjës për garancionin dhe zhvillimin e reparaturës. Ajo nuk ofron mbështetje të mjeteve private.
- siguron, që mjetet e huazuara të jenë të siguruar edhe jashtë rrjetit të shkollës me anë të një Content Filter<sup>1</sup> dhe me instalimin e një Antivirusi.

<sup>1</sup> Content-Filter shërbenë që, faqet e internetit ose E-Mailat të kontrollohen me një program i cili mundësisht edhe mund të bllokoj çasjen ndaj përmbajtjeve, nëqoftëse i klasifikon ato si joligjore apo të pamoralshme.

- **Nuk** merr përgjegjësi për dëmtimet, të cilat ndodhin nga pëdorimi i gabuar, moskujdesi dhe nga mospërmbajtja e kësaj rregullorje.
- Siguron përdorim në mjedise të ndryshme mësimore (libra digjital, Microsoft Office365, platforma mësimore) dhe siguron që, gjatë përdorimit të mjedisit mësimor të respektohet privatësia e të dhënave personale.
- Mbanë të drejtën për të kufizuar përdorimin e mjetit të huazuar.
- Ka të drejtë të bëjë vlerësim personal nga të dhënat e protokoluara, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm për abuzim. Një vlerësim i till mund të kryhet vetëm nën urdhërin e dhënë nga Administrata e shkollës apo nga Udhëheqësi.

## Roli i arsimtarëve: arsimtarët ...

- Tregojnë se si të duhet të silleni me mjetin gjatë orës mësimore dhe i aftësojnë nxënësit dhe nxënëset për përdorimin e teknologjisë dhe paisjet e saj.
- Kanë të drejtën që, në çdo kohë të kontrollojnë përmbajtjet e ruajtura në mjetin e huazuar.

## Roli i prindërve/kujdestarit ligjor: prindërit / kujdestarët ligjor...

- vendosin, nëse guxon ta përdor fëmiju i tyre mjetin e huazuar dhe si ta përdori atë. Për këtë mund të gjeni këshilla, psh. në faqen [www.projuventute.ch](http://www.projuventute.ch) (Medien&Internet) ose [www.jugendundmedien.ch](http://www.jugendundmedien.ch).
- krijonjnë rregulla të arsyeshme në shtëpi në lidhje me kohëzgjatjen e përdorimit të mjetit të huazuar si dhe përmbajtjet në të.
- Kanë të drejtë në çdo kohë, t'i kontrollojnë përmbajtjet në të dhe nëse e kërkon nevoja edhe ta detyrojnë fëmijun e tyre që t'i fshij ato.
- mbajnë përgjegjësinë për përdorimin e duhur të mjetit huazues në shtëpi.
- janë përgjegjës për fëmijët e tyre edhe për sjelljen e fëmijëve me mjetin e huazuar në shtëpi.
- Lajmërojnë Kujdestarin e klasës në rast dëmtimi apo humbjes së mjetit mbrenda 48 orëve, duke bërë të dhëna rreth mënyrës dhe arsyes së dëmtimit, gjegjësisht të humbjes, dhe në rast vjedhjeje duhet që të bashkangjiti raportin policor.

## Përgjegjësia

- Kujdestarët ligjor janë përgjegjës për dëmtimet e shkaktuara qëllimisht në infrastrukturën e rrjetit kompjuterik dhe internetit.
- Në përgjithësi ju guxoni t'i lidhni paisjet shtesë të juajat me mjetin e huazuar. Mirpo ato duhet që të përcaktohen si të përshtatshme nga prodhuesi i mjetit të huazuar. Kujdestarët ligjor janë përgjegjës nëse dëmtohen paisjet shtesë të cilat nuk ua ka dhënë shkolla.
- Qyteti i Schaffhausen-it nuk është përgjegjës në lidhje me dëmtimet që mund të paraqiten me mjetin e huazuar. E njëjta gjë vlen edhe për softwar-in i cili ju sigurohet nga shkolla dhe të cilin mund ta instaloni në mjetin tuaj privat (si psh. Microsoft Office365).
- Pas mbarimit të shkollës duhet mjeti i huazuar (si dhe paisjet e tij) t'i kthehet shkollës në gjendje të mirë ashtu si që ishte kur e morrët, kuptohet duke e marrë parasysh gjendjen e

përdorur. Nëqoftëse mungojnë pjesë ose është e dëmtuar, kujdestarët ligjorë duhet që ta paguajnë dëmin.

---

Me nënshkrimin tonë ne vërtetojmë që pajtohemi me rregulloren e përdorimit.

.....  
Emri dhe mbiemri i fëmiut

.....  
Vendi, Data dhe nënshkrimi i fëmiut

.....  
Emri dhe mbiemri i kujdestarëve ligjor

.....  
Vendi, Data dhe nënshkrimi i kujdestarëve ligjor